



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

23 shkurt 2022

SCC-08-0109

Paditësit

1. **Sh (M) B** Gjakovë
2. **N (M) B** Gjakovë
3. **R (M) B** Gjakovë
4. **Xh (M) B** Gjakovë
5. **F (M) B** Gjakovë
6. **R (M) B** Gjakovë
7. **F (M) B** Gjakovë

Kundër

Të paditurat

1. **Kuvendi i Komunal, Gjakovë.**
2. **NSH, “Ereniku”, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Sylejman Shumolli gjyqtar kryesues, Diellza Hoxha dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, pas seancës dëgjimore të datës 23 shkurt 2022, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. Procedura në këtë çështje juridike **NDËRPRITET** për shkak të vdekjes së paditësve **N B, F B dhe R B.**
2. Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të ndjerëve kërkojnë vazhdimin, apo kujdestari i tyre kërkon vazhdimin e procedurës, apo kur gjykata në bazë të propozimit të palës së kundërt kërkon që palët të vazhdojnë procedurën.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 22 prill 2008, paditësit dorëzuan në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (tutje Dhoma e Posaçme), padi kundër të paditurave Kuvendi Komunal në Gjakovë dhe NSH “Ereniku” e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (tutje AKP), me objekt të çështjes vërtetimin

e pronësisë dhe kthimin në posedim të qetë dhe të lirë të së njëjtës. Padiësit pretendojnë se janë pronar të ngastrës kadastrale nr. 4858 ZK Gjakovë-J-Qytet, me kulturë kullosë në sipërfaqe prej 0.38.84 ha. Padiësit pohuan se janë pasardhës të të ndjerit M B, të cilit i është marrë prona në mënyrë të kundërligjshme (shpronësuar) nga ana e Kuvendit Komunal në Gjakovë dhe i është transferuar në pronësi të K “E”, e cila parcelë është punuar dhe shfrytëzuar pandërprerë nga padiësit. Po ashtu padiësit pohuan se paraardhësi i tyre asnjëherë nuk është pajtuar ta shesë dhe se asnjëherë nuk kanë marrë kurrfarë kompensimi. Padiësit propozuan që gjykata ta aprovojë padinë e tyre si të bazuar, të anulohet vendimi nr. 7918/1-1958 i datës 25 gusht 1958 dhe të obligohet NSH “Ereniku” që parcelën kontestuese t’ia kthejë padiësve në posedim të qetë dhe të lirë. Në mbështetje të padisë kanë bashkangjitur ekstraktin nga flet posedimi të datës 23 mars 2006, aktvendimin 7918/1-1958 të datës 25 gusht 1958 dhe njoftimin e AKM të datës 01 nëntor 2006.

Me 25 prill 2008 gjykata lëshoi urdhër, me të cilin kërkoi nga padiësit që të parashtrojnë bazën ligjore të padisë, veçanërisht faktet materiale që i përkasin padisë. Me këtë urdhër nga padiësit u kërkua që të deklarojnë detajet e sakta të ligjit mbi bazë të të cilit toka në fjalë është marrë nga posedimi i padiësve apo paraardhësve të tyre ligjor, çfarë kompensimi siguron një ligj i tillë për kontestim të atij vendimi. Po ashtu nga padiësit u kërkuan detajet e sakta se si marrja e tokës është kontestuar në atë kohë, nga cilat organe dhe në çfarë kohe, detajet e sakta të provave të cilat tentojnë ti sigurojnë gjatë seancave mbi lëndën që të dëshmojnë pretendimet e tyre dhe përkthimin në gjuhën angleze të të gjitha dokumenteve.

Me 03 qershor 2008, padiësit u përgjigjen në urdhrin e gjykatës, dorëzuan kopjen e aktvendimit nr. 7918/1-1958 të datës 25 gusht 1958 dhe deklaruan se palujtshmëria i është marrë sipas nenit 45.1 të Ligjit mbi qarkullimin e tokës dhe ndërtesave “FL. Zyrtare ENRJ” nr. 26/54. Po ashtu padiësit pohuan se pronar legjitim sipas flete posedimit nr. 952-01-1302/06 me nr. Zonës Kadastrale 70705028 me flet posedim 948 është pasuri shoqërore K “E”. Me tej padiësit pohuan se në aktvendim shihet qarte se parcela nr. 4858 në sipërfaqe prej 0.38.84 ha është përvetësuar në bazë të ligjit të cekur me lartë pa kompensim.

Me 17 shtator 2008 gjykata lëshoi urdhër, me të cilin kërkoi nga padiësit që të paraqesin bazat ligjore të padisë dhe faktet materiale që kanë të bëjnë me padinë dhe listën e dëshmive që padiësit dëshirojnë ti paraqesin gjatë seancës dëgjimore. Po ashtu u kërkua nga padiësit që të dorëzojnë dëshmi se të njëjtit e kanë njoftuar agjencinë se kanë ndërmend të ushtrojnë padi kundër ndërmarrjes, si dhe të bëjnë përkthimin në gjuhën angleze të aktvendimit nr. 7918/1-1958 të datës 25 gusht 1958.

Me 14 tetor 2009, padiësit më parashtesë e bënë plotësimin e padisë dhe pohuan se paraardhësi i tyre asnjëherë nuk ka dalë nga posedimi, pra babai i tyre gjithmonë e ka punuar këtë pronë, po ashtu tani edhe ata e punojnë ngastrën kadastrale nr. 4858. Padiësit pohuan meqenëse toka është punuar vazhdimisht nga paraardhësi i padiësve dhe padiësit, i propozojnë gjykatës që me rastin e vendosjes të bazohet në nenin 40 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore Ligji nr. 03/L-154 i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës me datë 25 qershor 2009. Padiësit propozuan që të anulohet vendimi nr. 7918/1-1958 i datës 25 gusht 1958.

Me 10 dhjetor 2009, e paditura NSH "Ereniku" parashtrori përgjigje në padi në të cilën pohoi se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar nga fakti se e paditura është pronare dhe poseduese faktike dhe juridike e paluajtshmerisë kontestuese nr. 4858 ZK Gjakovë-J-qtet ne kulture kullosë në sipërfaqe prej 0.38.84 ha sipas FP.nr. 948. Po ashtu e paditura pohoi se kjo palujtshmëri është bartë që nga viti 1958 në bazë të vendimit nr. 7918/1-1958 të datës 25 gusht 1958 dhe se që nga kjo periudhë këtë ngastër e paditura e ka në posedim të qetë dhe të lirë. Me tej e paditura pohoi se e ka fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim dhe se paditësit nuk kanë të drejtë që të kërkojnë vërtetimin e të drejtës në pronësi dhe kthimin në posedim të qetë dhe të lirë të ngastrës kontestuese, sepse një kërkesë e tillë është e vjetërsuar.

Me 24 mars 2010 gjykata lëshoi urdhër me të cilin kërkoi nga e paditura NSH "Ereniku" që të dorëzojë një kopje të autorizimit ligjor, instrumenti ose instrumentet që e përbejnë apo e rregullojnë atë person juridik dhe ndonjë dëshmi tjetër të ekzistimit të saj dhe dëshmi se autorizimi që i është dhënë avokatit të të paditurit është diskutuar në mënyrën e duhur nga ana e ndonjë personi të autorizuar për këtë qëllim sipas ligjit në fuqi.

Me 22 prill 2010, AKP si përfaqësuese e të paditurës NSH "Ereniku", duke u përgjigjur në urdhrin e gjykatës dorëzoi autorizimin me të cilin AKP përmes zyrtarit të saj do ta përfaqësojë NSH, raportin për përcaktimin e statusit të NSH "Ereniku" Prodhimtaria Primare-Gjakovë dhe kërkesën e NSH për përfaqësim pranë Dhomës së Posaçme në rastin SCC-08-0109.

Me 08 qershor 2010, Dhoma e Posaçme me aktvendimin SCC-08-0109 e pezulloi procedurën në këtë çështje, deri sa të vendoset për statusin e të paditurës NSH "Ereniku" në lëndën SCC-08-0124 dhe vendimi për këtë çështje ta merr formën e prerë.

Me 13 nëntor 2020, AKP parashtrori përgjigje në padi, në të cilën pohoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësve, duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj. AKP pohoi se paditësit e kanë parashtruar padinë në kundërshtim me parimin procedural legitimacio ad causam, i cili ka të bëjë me legjitimitetin real aktiv të palës. Po ashtu AKP pohoi se nga shkresat e lëndës dhe nga vetë thëniet e paditësve konstatohet se e paditura NSH "Ereniku", e përfaqësuar nga AKP, është bërë pronare e ngastrës 4858 ZK-Gjakovë-J-Qytet, në bazë të vendimit 7918/1 të datës 25 gusht 1958. Me tej AKP pohoi se sipas nenit 29 të Ligjit mbi Marrëdhëniet pronësore –Juridike nr. 6/1980, mbi sendin në pronësi shoqërore e drejta e pronësisë nuk mund të fitohet me parashkrim fitues, andaj nga kjo edhe vijmë në përfundim se padia e paditësve nuk është e bazuar në ligj. AKP propozoi që padia e paditësve të refuzohet si e pa bazuar.

Me 08 shkurt 2022, Dhoma e Posaçme, në këtë çështje ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesi i palës së paditur AKP, ndërsa nuk ka prezantuar pala paditëse, të cilët kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e kanë arsyetuar. Gjyqtari kryesues fillimisht njoftoi se me 08 shkurt 2022, para fillimit të seancës është lajmëruar në telefon të gjykatës djali i paditësit N B, për këtë zyra e regjistrat ka

bërë një konstatim i cili është dorëzuar në e-mail, i njëjti ka njoftuar gjykatën se nuk mundem me ardh në seancën dëgjimore pasi babai i tij N B ka ndërruar jetë, po ashtu ka njoftuar gjykatën se nuk janë në jetë edhe paditësit F dhe R B, ndërsa paditësit e tjerë të cilët janë gjallë Sh, Xh dhe F nuk kanë mundur të vijnë sepse janë të vjetër dhe gjendja shëndetësorë e tyre nuk është e mirë, kurse përfaqësuesi i të paditurës AKP, deklaroi se nuk ka diçka për të shtuar, i len gjykatës për të vendosur.

Arsyetimi ligjor:

Procedura në këtë çështje juridike ndërpritet për shkak të vdekjes së paditësve N B, F B dhe R B.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh:

Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Sipas dispozitës së nenit 277 pika (a) të LPK-së: *Procesi gjyqësor ndërpritet:*

a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim;

Ne vazhdim dispozita e nenit 280 par. 1 të LPK-së parasheh:

Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

Me 24 janar 2022, paditësve gjykata ju ka dërguar urdhrin për seancë dëgjimore, të cilët urdhrin e kanë pranuar me 26 janar 2022.

Me 08 shkurt 2022, para fillimit të seancës dëgjimore, zyra e regjistrimit të Dhomës së Posaçme ka pranuar një telefonatë nga djali i njërit prej paditësve, për të cilën telefonatë zyra e regjistrimit ka bërë një shënim zyrtar përmes e-mail-it zyrtar. Me këtë e-mail është njoftuar kryesuesi i kolegjit se paditësit nuk mundem me u paraqit në seancën dëgjimore pasi babai i tij N B ka ndërruar jetë, po ashtu ka njoftuar gjykatën se nuk janë në jetë edhe paditësit F dhe R B, ndërsa paditësit e tjerë të cilët janë gjallë Sh, Xh dhe F nuk kanë mundur të vijnë sepse janë të vjetër dhe gjendja shëndetësore e tyre nuk është e mirë.

Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 277 pika (a) dhe nenit 280 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Këshilla juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli, Gjyqtar kryesues

Diellza Hoxha, Gjyqtare

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar